



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA		
QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVO		
MINISTRIA E BUEJTARISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL		
MINISTRI OF AGRICULTURE, FORESTRY AND RURAL DEVELOPMENT		
Arke - Dendror - Centralna Arhiva - Central Archive		
Nr./Br.No.	3323	
Nr. i fq./Br. Str. No.	2	
Datumi/Date	10.08.2023	
PRISHTINE - PRISTINA - PRISTINA		

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja
Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development

Kabineti i Ministrit / Kabinet Ministra / Cabinet of the Minister

Datë: 08.08.2023
Ref. KM-289/23

Në mbështetje të nenit 145 (paragrafi 2) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke marrë parasysh nenet 8, 9, 10 dhe 11 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare, Nr. 7/ 01 mars 2019), duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 1.4) neni 15, Shtojca 11 të Rregullores (QRK)-Nr.02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (30.03.2021), dhe Nenin 20 (paragrafët 1, 4 dhe 5) të Ligjit Nr. 03/L-042 i Produkteve për Mbrojtjen e Bimëve, (Gazeta Zyrtare Nr. 44, datë 22.12.2008) si dhe në bazë të rekomandimit të Komisionit për vlerësim dhe autorizim të Produkteve për Mbrojtjen e Bimëve, me Ref.04-382/23, të datës 31.07.2023, Ministri i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, nxjerrë:

VENDIM

Për futjen në regjistër dhe lejimin e autorizimit të produktit për mbrojtjen e bimëve për përdorim

1. Lejohet importimi, vendosja në treg dhe përdorimi i autorizimit të produktit për mbrojtjen e bimëve – Quickphos i prodhuesit “UPL Europe Ltd.”, Mbreteri e Bashkuar nga përfaqësuesi i saj “Agropharma” Sh.P.K, Viti.

2. LLOJI I PRODUKTIT: Insekticid, Rodenticid

3. PËRMBAJTJA E SUBSTANCËS AKTIVE: Aluminium Phosphide.....56%

4. PËRDORIMI:

Quickphos përdoret vetëm nga persona të autorizuar, përdoret për luftimin e dëmtuesve të depove kur drithrat janë rifuxho 2-6 tableta për ton. Për luftimin e dëmtuesve të depove kur drithërat janë në thase 1-3 tableta për m³. Për luftimin e dëmtuesve të duhanit te depo 0.5-1 tableta për m³. Për luftimin e dëmtuesve në ushqimet e paketuara 1-3 tableta për m³. Për dezinfektim të depove apo mjediseve të tjera të mbyllura 1-3 tableta për m³.

Kohëzgjatja e trajtimir varet nga temperatura e mjedisit:

4 ditë-15-20°C

7 ditë-10-15°C

14 ditë-5-10°C

5. SASIA E AMBALAZHIMIT PËR IMPORTIM:

Kanaqe metalike 480 gr peshe neto; 1 tub alumini x 10 tableta x 3 gr tab x 16 tuba

6. VËREJTJE:

Përdorimi i Quickphos është i lejuar vetëm për persona të cilët janë të paisur me deshmi kualifikimi të veçant. Dhomat ose mjediset e tjera të cilat kufizohen me ambientin që dezinfektohet duhet të ajrosen gjithmonë dhe duhet të kufizohet qëndrimi në to. Përdoruesit e këtyre duhet të jenë të informuar për rrezikun që vjen nga dezinfektimi me Quickphos.

7. KARENCA:

Nuk aplikohet.



GHS02-i ndezshëm

8. PROPOZIMI I KLASIFIKIMIT:



GHS06-helmues



GHS09-paralajmerim (cat-i rrezikshëm për ambient).

9. VENDI I SHITJËS: Në tërë territorin e Republikës së Kosovës.

10. Produkti për mbrojtjen e bimëve i autorizuar nga pika 1 e këtij vendimi lejohet të importohet në Republikën e Kosovës, deri në afatin siç është përcaktuar në certifikatën e regjistrimit, duke u bazuar në Databazën e Pesticideve të BE-se/Substancave aktive, ndërsa qarkullimi dhe përdorimi i tij lejohet sipas nenit 26 paragrafi 3 i Ligjit Nr.03/L-042 i Produkteve për Mbrojtjen e Bimëve.

11. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Vendimi i dërgohet:

- Komisioni për vlerësimin dhe autorizimin e produkteve për mbrojtjen e bimëve;
- Departamenti i Politikave Bujqësore dhe Tregjeve;
- Shërbimi kufitar fitosanitar;
- Inspektorët fitosanitar AUV;
- Importuesit të produkteve për mbrojtjen e bimëve;
- Arkivit.



Faton Peci

Ministër